



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 943/01-5032 dt. 29. 01 2024



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë nr.01-420 të dt.22.01.2024, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelës kadastrale në Kishnarekë, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e Stacionit Sizmik Sekondar.

Neni 2

Parcela që kërkohet të ndahet, është si më poshtë:

1. Parcela kadastrale Nr.872-2 zona kadastrale Kishnarekë, propozohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale me sipërfaqe $S=0.01.00$ ha.

Neni 3

Qëllimi i ndarjes së parcelës kadastrale 872-2 në zk. Kishnarekë, bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të Objektivit të Stacionit Sizmik Sekondar në Kishnarekë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.


Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



ARSYETIM

Me qëllim të realizimit të investimit nga Ministria e Ekonomisë-Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, për ndërtimin e objektit të 'Stacionit Sizmik Sekondar' në fshatinë Kishnarekë, kërkohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimin e objektit të Stacionit Sizmik Sekondar në fshatinë Kishnarekë, nevojitet një sipërfaqe prej 100 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 872-2.


Duke pasur parasyshë kërkesën nr.01-420 të dt.22.01.2024 të Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për ndërtimin e objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonën kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

E cili ju është drejtuar Kryetarit të Komunës së Drenasit për iniciimin e procedurave për të lëshuarë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të sipërfaqen prej 100 m², e cila është pjesë e parcelës 872-2 në zonën kadastrale Kishnarekë.

Drejtorati për Gjeodezi. Kad. dhe Pronë me datë.22.01.2024 ka caktuar ekipin profesional i cili ka dal në vendshiqim dhe ka bërë matjet gjeodezike për lokacionin për ndërtimin e objektit-të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonën kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë:

- Kërkesa nr.01-420 dt.22.01.2024 e Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjik të Kosovës;
- Certifikata mbi të drejtat e pronës;
- Kopja e planit si dhe
- Skica se ku do bëhet ndërtimi i objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në Zonën Kadastrale Kishnarekë, të Komunës se Drenasit .



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr. 934/01-5032 për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024

I nderuar kryetar Lladrovci,
I nderuar kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 01.02.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin 02 Nr. 934/01-5032 për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin 02 Nr. 934/01-5032 për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glogocit, datë 29.01.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Vendimi i lartshënuar është i bazuar në Udhëzimin Administrativ Mmph - Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe në Kornizën e Punës për Matje. Andaj, mund të vazhdohet me procedurën për ndarjen e parcelës, pasi e njëjta është në pronësi të komunës.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Glogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

